



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:137427 **C. nr. 2165/2023**
Datë: 06.02.2024
Numri i dokumentit: 05287933

GJYKATA THEMELORE PRIZREN, me gjyqtar Atdhe Berisha, në çështjen juridiko-kontestimore sipas padisë së paditësit N.B. nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati F.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, për anulimin e vendimit, në seancën publike përgatitore me datë 05 Shkurt 2023, morri këtë:

A K T V E N D I M

Konstatohet e tërhequr padia në këtë çështje kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi N.B. me padinë e paraqitur përmes të autorizuarit të vet kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, ka kërkuar nga gjykata të anulon vendimin me të cilin e paditura ka ndërprerë marrëdhënien e punës me paditësin.

Gjykata në këtë lëndë me datë 05 Shkurt 2024 ka caktuar seancën përgatitore në të cilën seancë ka qenë prezent i autorizuari i paditëses dhe e autorizuarja e të paditurës. I autorizuari i paditësit njofton gjykatën që ngel në tersi si në parashtresën e datës 15 Shtator 2023, me të cilën sqaron se e tërheq padinë e paraqitur.

Pasi që pala paditëse e tërheq padinë dhe pala e paditur e jep pëlqimin për tërheqjen e padisë, gjykata në kuptim të nenit 261 të LPK-së, vendosi që të konstaton se padia është tërhequr.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr. 2165/2023 datë 05 Shkurt 2024.

Gj y k a t ë s i
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.